



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:221507

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05922031

P.nr.130/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit R. I., për shkak të veprave penale: “Kanosja” nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4882/2022, të datës 21.11.2022, pas përfundimit të seancës së mbyllur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 08.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Vjosa Bytyçi, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit E. D. av. B. A., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. M. H., me datë 09.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

R. I., nga i ati N. dhe nëna F. e vajzërisë G., i lindur më ... në fshatin S. të P., me vendbanim Rr. “F.” p.nr. Komuna P., me qëndrim në Gj., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme teknike, me profesion punëtor në firmën “R. I. G.”, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në ndalim 26.10.2022, deri me datë 27.10.2022.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Më datë 25.10.2022 rreth orës 18:40 minuta në rrugën “... ..” në P., i pandehuri me qëllim të frikësimit ka kanosur seriozisht të dëmtuarin—ish dhëndrin e tij E. D., në atë mënyrë pasi takohen në rrugë i pandehuri me gjeste, fjalë dhe me përdorimin e mjetit të rrezikshëm-(vegël pune nga metali), mjetë ky me të cilin mund të shkaktohet lëndim i rëndë trupor ose dëmtim i rëndë për shëndetin, vihet me vrap pas të dëmtuarit të cilin e ndjek deri brenda në shtëpinë e tij, ku e dëmton derën e shtëpisë hyn brenda dhe i drejtohet me fjalë “*Ti q. me rob, e me krejt çka ki*”, mirëpo i dëmtuari nga frika arrin që të fshehet në bodrumin e shtëpisë, me këto veprime tek i dëmtuari kishte shkakuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetën pasi që nuk ishte hera e parë që ata kishin probleme.

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë, i pandehuri me dashje ka dëmtuar dhe ka bërë të pa përdorshme pasurinë e të dëmtuarit E. D., në atë mënyrë që pasi vihet me vrap pas të dëmtuarit të cilin e ndjek deri brenda në shtëpinë e tij, ku e dëmton derën e shtëpisë nga plastika dhe hynë brenda për të kanosur, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material.

- me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Në bazë të nenit 76 par. 1 të KPRK-se, të pandehurit i:

### P Ë R C A K T O N

- Për veprën penale si në ikën (I) i cakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) Euro.

- Për veprën penale si në pikën (II) i shqipton Dënim me Gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 76 par. 2 nën-par. 2.4 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 449 par. 2 nën-par. 2.6 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

### G J Y K O N

I. ME DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej gjashtëqind (600) Euro, llogaritur kohën e kaluar në ndalim nga data 26.10.2022, deri me datë 27.10.2022, i pandehuri detyrohet të paguaj shumë prej pesëqind e tetëdhjetë (580) Euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në afatin e përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t' i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do t' i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale – për paushallin gjyqësor të paguajë shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumë prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

IV. I dëmtuari E. D., me vendbanim në Rr. "... ..." në P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsërishëm.

V. Konform nenit 269 të KPP-së, të pandehurit i konfiskohet ... (...) vegël pune metali (...), si mjet i kryerjes së veprës penale.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4882/2022, të datës 21.11.2022, kundër të pandehurit R. I., B. H., për shkak të veprave penale: “Kanosja” nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 29.05.2023, në të cilin i pandehuri ka pranuar fajësinë, dhe sipas aktgjykimit P.nr. ... , të datës 30.05.2023, i njëjti është shpallur fajtor dhe gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej pesëqind e tetëdhjetë (580) Euro.

Kundër aktgjykimit si më lartë pala e dëmtuar me datë 07.09.2023 ka parashtruar ankesë në nëpërmjet kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet për shkak të vendimit mbi dënimin dhe pjesërisht të vendosë lidhur me kërkesën pasurore juridike, përveç kësaj, i dëmtuari po ashtu në arsyetimin e ankesës ka theksuar se nga gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë fare i njoftuar për seancën e shqyrtimit fillestar, detyrim ligjor ky i paraparë me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 të KPP-së.

Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesën e palës së dëmtuar dhe sipas detyrës zyrtare, sipas aktvendimit ..., të datës 21.12.2023, ka aprovuar të njëjtën, aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në P. P.nr....., i datës 30.05.2023 është anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, fillimisht ka njoftuar palët për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar i cili është mbajtur me datë 08.07.2024, në të cilin edhe përkundër njoftimit në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, i dëmtuari nuk ka prezantuar fakt për të cilin ka njoftuar gjykatën, mirëpo meqenëse përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit ishte prezent, shqyrtimi fillestar ka vazhduar në mungesë të palës së dëmtuar.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, pasi që i pandehuri nga gjyqtari i vetëm gjykues është udhëzuar për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, ka shprehur keqardhje për veprimet e tij, i njëjti ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, nga gjykata ka kërkuar një sanksion më të butë penal.

Gjykata konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pranimi i

fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i njëjti, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që ky pranim është bërë me vullnetin e tij dhe në konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, andaj me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata të merr për bazë pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese shkallën e lartë të dashjes për të kryer veprat penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, po ashtu të detyroj të pandehurin të kompensoj dëmin në vlerë prej nëntëqind (900) Euro siç është përcaktuar në aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit R. I. avokat M. H. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se i mbrojturi i tij edhe në fazat e mëhershme ka pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë, me rastin e caktimit të llojit të sanksionit penal si rrethanë lehtësuese gjykata të merr parasysh pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur, kërkim faljen dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, nga gjykata kërkoi që të njëjtit t'i shqiptoi një dënim sa më të butë, ndërsa e refuzojnë lartësinë e dëmit të përcaktuar si në pikën II të aktakuzës, për arsye se nuk ka ndonjë provë relevante, bindëse që vërteton me saktësi lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit E. D. av. B. A., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e mbështetë në tërësi deklarin dhe propozimin e prokurores së shtetit, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit lidhur me caktimin e sanksionit penal nga gjykata ka kërkuar të ketë parasysh të gjitha rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së këtyre veprave penale, të peshojë ndikimin dhe pasojat të cilat i janë shkaktuar tani të dëmtuarit, dëmin material dhe jo material, kjo ngase i dëmtuari ka qenë i detyruar të marr trajtim mjekësor për shkak të veprave penale të kryera dhe të pranuar nga i pandehuri.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh dashjen e lartë të kryesit dhe këmbënguljen për të kryer veprën penale, e manifestuar përmes veprimeve proaktive të tij, i cili fillimisht e ndjek të dëmtuarin dhe me përdorimin e mjetit të rrezikshëm (vegël pune nga metali), dëmton derën e shtëpisë së të

dëmtuarit dhe futet brenda, andaj duke i vlerësuar këto rrethana gjykata ka aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit nën kufirin e paraparë ligjor dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprave penale të kryera nga i pandehuri, shkallën e përgjegjësisë penale të tij si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Për veprën e parë penale si në pikën (I) “Kanosja” nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, parashihet dënim me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Konform nenit 71 par. 1 nën-par. 1.3 të KPRK-së është përcaktuar se: “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “... në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”.

Konform nenit 72 par. 1 nën-par. 1.5 të KPRK-së: “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: “...nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënim me burgim prej një (1) viti, dënim mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”.

Konform nenit 44 par. 1 të KPRK-së “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënim me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim në dënimin e shqiptuar është marrë në bazë të nenit 79 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marrë në kuptim të nenit 44 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e mjetit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është marrë në bazë të nenit 269 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal  
P.nr. 130/2024, datë 10.07.2024

Procesmbajtëse  
Erblina Aliu

---

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.